



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Blerina Huruglica</b>	<b>06.03.2026</b>	<b>11.03.2026</b>	<b>2026/0127</b>

### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 02.03.2026, OE “WOOD CORPORATION L.L.C.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0127, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë Pjesa I :OE “FWRDZ LLC & Arta Tex Group SHPK”, Pjesa II: “EMPREUS” SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit: “FURNIZIM ME PIZHAME DIMRI DHE ÇORAPË PËR ZYRTARET POLICORË” me nr. të prokurimit: "214/30400-25-9367-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **Total: 333,000.00 euro**

**Pjesa 1 -297,000.00 euro**

**Pjesa 2- 36,000.00 euro**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankes.

### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

#### I. HYRJE

1. Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës (tutje: Autoriteti Kontraktues) ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Pizhame Dimri dhe Çorapë për Zyrtaret Policorë” me numër të prokurimit: 214/30400-25-9367-1-1-1.

2. Brenda afatit të përcaktuar në dosjen e tenderit, grupi i operatorëve ekonomik Wood Corporation LLC dhe Puntex SHPK (tutje: Ankuesi) kanë dorëzuar ofertë për këtë aktivitet të prokurimit në të dy pjesët e kontratës, duke përfshirë furnizimin me çorape dhe furnizimin me pizhame.

3. Me datën 05.12.2026 Autoriteti kontraktues ka bërë hapjen e ofertave dhe leximin e çmimeve.

4. Me datën 13.02.2026 Autoriteti kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (tutje: Vendimi i Kontestuar) me anë të së cilit kemi kuptuar se oferta jonë është eliminuar në të dy pjesët si kinse e papërgjegjshme, përkundër se i kemi plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara në dosjen e tenderit.

5. Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim duke i përmendur të gjitha arsyet pse duhet të aprovohet kërkesa për rishqyrtim dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

6. Me datën 20.02.2026 Autoriteti kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim kinse si të pabazuar dhe ka vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 13.02.2026. Duke qenë se kemi mbetur të pakënaqur me këtë shqyrtim të kërkesës sonë dhe ofertës, Ankuesi paraqet këtë ankesë sipas pretendimeve që do të sqarohen si në vijim.

## **II. BAZA LIGJORE PËR APROVIMIN E ANKESËS DHE RIVLERËSIMIN E LËNDËS**

5. Në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues tek arsyet e eliminimit të ofertës së Ankuesit ka deklaruar: Qepja është e çrregullt, me fije të nxjerrura dhe joprofesionale shih në foto [Vendimit të kontestuar i janë bashkangjitur gjashtë fotografi].

6. Në anën tjetër, nëse shihet dosja e tenderit, sa i përket qepjes së pizhameve në Aneksin 1 – Specifikacioni i detyrueshëm teknik, është kërkuar: “Komplet qepja te jete e forte dhe e sigurt (qepje profesionale dhe penjës profesional)” Kërkesa për qepje nuk është thirrur në ndonjë metodë specifike, standard specifik të aplikueshëm por vetëm ka kërkuar qepje profesionale dhe të sigurt.

7. Autoriteti kontraktues në këtë rast e ka konstatuar se qepja e produktit nga ana e Ankuesit nuk është profesionale, pasi që në të janë hasur disa fije të perit e të cilat nuk kanë qenë në asnjë formë të ndaluar në dosje të tenderit. Pra komisioni për vlerësimin e ofertave dhe veçanërisht Zyrtari përgjegjës i prokurimit ka tejkaluar kriteret e dosjes së tenderit dhe kanë përdorur kritere jo të barabarta dhe të papërcaktuara në dosjen e tenderit për eliminimin e ofertë së Ankuesit.

8. Rikujtojmë se Ankuesi është prodhues vendor dhe i njëjti në këtë aktivitet të prokurimit artikujve u ka kushtuar vëmendje të shtuar ashtu që e gjithë përgatitja e mostrave ka qenë e përgatitur në përpikëri me kërkesat e dosjes së tenderit. Shtimi i etiketave që ka ndodhur mbi produkte nuk është arsye për eliminim të ofertës, pasi që të gjitha kushtet janë plotësuar duke përfshirë kualitetin, përbërjen dhe qepjen e materialit. Vlerësimi vizual dhe jo bazuar në kompetencë nga ana e autoritetit kontraktues është arbitrar dhe diskriminon ofertën e prodhuesve vendor.

9. Asnjë laborator apo profesionit i tekstit nuk ka qenë në i përfshirë në procesin e vlerësimit apo përbërje të komisionit të vlerësimit të ofertave, prandaj gjetja se oferta është e papërgjegjshme për shkak të qepjes “jo profesionale” është tërësisht e pabazuar në ligj dhe dosje të tenderit. Edhe në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim pa argumente dhe me kokëfortësi ZPP tenton të mbrojë vendimin e tij kinse qepja ishte jo profesionale, pavarësisht se këtë vlerësim e ka bërë vetëm në mënyrë vizuale pa pasur asnjë lloj ekspertize në fushën e qepjes së tekstit.

10. Tutje, në Vendimin e kontestuar sa i përket arsyeve për eliminim të ofertës thuhet: “OE ka deshtuar ne master per Pjesen 1 (artikulli 3) dhe 2. Mostra e ofruar nga OE, nuk permban asnjë deshmi, tiket te permbajtjes dhe prodhuesit, andaj oferta i refuzohet, nga pikat e larteshenuara OE eshte I

papergjegjshem.” Në këtë pjesë të konstatimit nuk është e qartë se për cilin produkt flet autoriteti kontraktues, dhe për cilin llot, kur dihet se në këtë aktivitet janë ofruar të produkte si pizhamet për meshkur dhe femra dhe qorapet për dy modele. Prandaj, edhe kundërshtimi i këtij konstatimi abstrakt është i vështirë. Sidoqoftë, nëse Autoriteti kontraktues konsideron se ka pasur mungesë të të dhënave të prodhuesit dhe të përbërjes së materialeve, kjo është e pavërtetë pasi që të njëjtat janë ofruar për të gjitha produktet duke përfshirë, çorapet dhe pizhamet. Në anën tjetër mos vendosja e llogos së prodhuesit në paketime, nuk mund të jetë bazë për eliminim, pasi që siç shihet nga vet Vendimi i kontestuar, produktet kanë pasur etiketën dhe për më tepër kanë pasur edhe atestimin e laboratorit të certifikuar. Rregullorja e Prokurimit Publik në nenin 37.4 ka paraparë anonimizimin e mostrave për të mos pasur vlerësime jo objektive të tenderëve.

Po të ishin vendosur shenjat në produkte një gjë e tillë do të ishte e pamundur. Neni 37 par. 4 i Rregullores përcakton: “Në mënyrë që të parandalohen mundësitë e njëanshmërisë së përzgjedhjes, para procesit të vlerësimit, mostrave të dorëzuara duhet t’i: a. eliminohen të gjitha shenjat të cilat mund të identifikojnë OE”.

11. Me këtë formë të vlerësimit Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 3 i Ligjit të Prokurimit Publik në të cilin përcaktohet: “Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë vetëm kriteret që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës. Kriteret të tilla janë por nuk kufizohen në lidhje me: cilësinë, çmimin, meritat teknike, estetike, dhe karakteristikat funksionale, karakteristikat e mjedisit, shpenzimet rrjedhëse, efektiviteti i kostos, shërbimet e pasqitjes dhe asistencat teknike.”

12. Autoriteti kontraktues po ashtu ka bërë shkelje të nenit 10 të Ligjit për Prokurimin Publik pasi që nuk ka ofruar qasje në atestet e operatorit të rekomanduar për kontratë në Llot 2, me arsyetimin se është kërkuar sekret afarist. Siç dihet nga praktika e deri tanishme kriteret vlerësuese si përmbajtja e materialit nuk mund të mbrohen si sekrete afariste, pasi që në to nuk ka të dhëna që mund të dëmtojnë konkurrencën e lirë në mes të operatorëve.

Duke u bazuar në të gjitha arsyet e lartcekura me respekt i kërkojmë Organi Shqyrtues i Prokurimit që këtë Ankesë ta aprovoj si të bazuar dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues.

## KRITERET PËR VLERËSIM

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

## B42 - Letër standarde për tenderuesin e eliminuar <sup>15</sup>

30.01.2026, Prishtine

**POLICIA E KOSOVES**, Rr "Luan Haradinaj"- nr. 99 ndërtesa e re e Administratës te Policisë, kati II, zyra e Prokurimit nr. 31, Prishtinë, Kosovë

Operatori Ekonomik: Grup i Operatorëve Ekonomik **WOOD CORPORATION L.L.C.**; **PUNTEX SH.P.K.Rr.Ukë Bytyqi, Suharekë**

Nr. i prokurimit <sup>16</sup>	214/30400-25-9367-1-1-1
Nr i brendshëm	214/30400-25-118-1-1-1

### Titulli i kontratës: **FURNIZIM ME PIZHAME DIMRI DHE ÇORAPË PËR ZYRTARET POLICORË**

I/e nderuar(a)

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04 /L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP"

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

OE ka ofertuar për Pjesën 1 dhe Pjesën 2

OE ka dështuar ne Aneksin 1 te DT për 2 Pjesët si ne vijim:

Ne Aneksin 1 te DT kërkesa eshte

"Komplet qepja te jete e forte dhe e sigurt (qepje profesionale dhe penjës profesional)"

OE ka paraqitur mostrat te cilat nuk përkojnë fare me kërkesat e AK

Qepja eshte e çrregullt, me fije te nxjerrura dhe joprofesionale shih ne foto:

Foto 1.

Foto 2.



Foto 3.

Foto 4.



Foto 5.

Foto 6.



OE ka dështuar ne mostër për Pjesën 1 (artikulli 3) dhe 2. Mostra e ofruar nga OE, nuk përmban asnjë dëshmi, tiket te përmbajtjes dhe prodhuesit, andaj oferta i refuzohet, nga pikat e larteshenuara OE eshte I papergjegjshem.

#### INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

///

#### VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

///

#### VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

///

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

///

## PËRGGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - WOOD CORPORATION L.L.C.

Aktiviteti i prokurimit me titull: “FURNIZIM ME PIZHAME DIMRI DHE ÇORAPË PËR ZYRTARET POLICORË” me nr. të prokurimit: “214/30400-25-9367-1-1-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, procedurë e hapur, lloji i kontratës furnizim, kriteri cmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër Njoftimit B58 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues (AK), I cili rekomandon për kontratë Operatorët Ekonomik (OE):

Pjesa I: Grupi I Operatorëve Ekonomik FWRDZ LLC & Arta Tex Group SHPK;

Pjesa II: EMPREUS SHPK

Ndërsa Operatori Ekonomik ankues është shpallë I eliminuar me arsyetimin:

OE ka ofertuar për Pjesën 1 dhe Pjesën 2

OE ka dështuar në Aneksin 1 të DT për 2 Pjesët si në vijim:

Në Aneksin 1 të DT kërkesa është

“Komplet qepja të jete të forta dhe të sigurt (qepje profesionale dhe penjër profesionale)”

OE ka paraqitur mostrat të cilat nuk përkojnë fare me kërkesat e AK

Qepja është e çrregullt, me fije të nxjerrura dhe joprofesionale shih në foto:

Foto 1.

Foto 2.



Foto 3.



Foto 4.



Foto 5.

Foto 6.



OE ka dështuar ne mostër për Pjesën 1 (artikulli 3) dhe 2. Mostra e ofruar nga OE, nuk përmban asnjë dëshmi, tiket te përmbajtjes dhe prodhuesit, andaj oferta i refuzohet, nga pikat e larteshenuara OE eshte I papergjegjshem.

Tutje, OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, I njëjti parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK nuk ka vlerësuar drejtë ofertat dhe se gjatë vlerësimit të ofertave shkelë Ligjin e Prokurimit Publik.

Ankesa është e parashtruar me pretendime kundër arsyes së eliminimit, I cili ka ofruar ofertën më të lirë se sa OE të rekomanduarit.

*(Shënim: pretendimet e ankesës gjenden të përshkruara lartë tek pjesa Dispozitat e Shkelura dhe Pretendimet Ankimore)*

#### **Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues:**

**Ekspertja shqyrtuese** pas analizmit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK në Dosje të Tenderit (DT) si kërkesë mbi mundësitë teknike dhe ose profesionale ka kërkuar:

**d) Operatori Ekonomik duhet te ofroj Atestet nga nje laborator I akredituar, per artikuj 1 dhe 2 per pjesen 1 sipas specifikacioneve Teknike te Aneksi 1**

**d) Operatori Ekonomik duhet te ofroj Atestet nga nje laborator I akredituar, per artikujt 1 dhe 2 ne pjesen 1 sipas specifikacioneve Teknike te Aneksi 1 Çertifikata duhet te posedojne linkun e faqes per verifikim online te validitetit te certifikatave,**

**nje email dhe AK posedon te drejten per verifikim te cdo dokumenti.**

**Specifikimet teknike për pjesën e parë janë kërkuar:**

**PIZHAMET PËR MESHKUJ**

- Te jete standarde;
- Përbërja duhet te jete përafërsisht 75%-90% pambuk , 25 %-10% liker; **te dëshmohet me a-test.**
- Me mënge te gjata
- Këmbët dhe duart te jene te ngushta ;
- **Rip elastik tek beli (Ilastik qemer te gjere)**
- Ne te dy mëngët poshtë te jene elastice ;
- Ne te dy këmbët poshtë te jene elastice ;
- **Te jete adekuate për meshkuj ne pjesën e përparme**
- Jaka tek pizhamet te jete e rumbullakët
- Ngjyra te jete e kaltër errët (teget),vetëm njëngjyreshe pa shenja tjera
- Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj pastrimit kimik
- Te ketëthurje te lehte rreth jakës te kufizuar deri ne përfundim te pjesëve te përparme;
- Pizhamet duhet te ketë tiketën ose emrin e prodhuesit te vendosur brenda saj, si dhe numri qe mban duke llogaritur me numrat si psh: XS,S,M,L,XI,XXL,XXXL .
- Te ketë tiketën brenda me specifikacione (qe përshkruhet materiali, etj);
- **Komplet qepja te jete e forte dhe e sigurt (qepje profesionale dhe penjës profesional)**

**PIZHAMET PËR FEMRA**

- Te jete standarde;
- Përbërja duhet te jete përafërsisht 75%-90% pambuk , 25 %-10% liker; te dëshmohet me a-test.
- Me mënge te gjata
- Këmbët dhe duart te jene te ngushta ;
- Rip elastik tek beli (Ilastik-qemer te gjere)
- Ne te dy mëngët poshtë te jene elastikë
- Ne te dy këmbët poshtë te jene elastikë
- Jaka tek pizhamet te jete e rumbullakët
- Ngjyra te jete e kaltër errët (teget) vetëm njëngjyreshe pa shenja tjera
- Qëndrueshmëria e ngjyrës ndaj pastrimit kimik;
- Te ketëthurje te lehte rreth jakës te kufizuar deri ne përfundim te pjesëve te përparme;
- Pizhamet duhet te ketë tiketën ose emrin e firmës te vendosur brenda saj, si dhe numri qe mban duke llogaritur me numrat si psh: XS,S,M,L,XI,XXL,XXXL .
- Te ketë tiketën brenda me specifikacione (qe përshkruhet materiali, larja, etj);
- **Komplet qepja te jete e forte dhe e sigurt (qepje profesionale dhe penjës profesional);**
- Afati i liferimit 45 ditë kalendarike.

### Çorapë

- Pambuk 75%-85%
- Elastike 25%-15%
- Ngjyra te jete e kaltër errët (teget)
- Madhësia-36 deri 47
- Unisex

### Si dhe specifikimet teknike per pjesën e dytë janë kërkuar (vetëm çorape termike):

#### ÇORAPE TERMIKE

- Përbërja duhet te jete përafërsisht
- Polipropolen 33%
- Polyamid 33%
- Eool 32%
- Elastan 2%
- **Tolerancë prej  $\pm 10\%$  .**
- Ngjyra te jete e kaltër errët (teget) ose e zezë
- Madhësia-36 deri 47
- Unisex

**Ndërsa**, OE ankues sipas letrës standarde B42 mbi eliminimin e tyre, janë eliminuar me arsyetimin se bazuar në mostra, qepja nuk është profesionale por është qepje e crregullt me disa fije të nxjerrura.

Rrjedhimisht OE ankues pretendon se:” qepja është profesionale, përkundër që ka disa fija të perit, mirëpo nuk është kontestuese qepja pa ndonjë ekspertizë e fushës së tekstilit, gjithashtu edhe përbërja e komisionit nuk ka qenë adekuat për arsye se nuk ka pas profesionit të fushës. Atestet janë, kurse komisioni ka bërë vetëm vlerësimin në mënyrë vizuale. Në anën tjetër mos vendosja e llogos së prodhuesit në paketime, nuk mund të jetë bazë për eliminim, pasi që siç shihet nga vet Vendimi i kontestuar, produktet kanë pasur etiketën dhe për më tepër kanë pasur edhe atestin e laboratorit të certifikuar. Dhe sipas Rregullores për Prokurim Publik në nenin 37.4 ka paraparë anonimizimin e mostrave [ër të mos pasur vlerësime jo objektive të tenderave. Autoriteti kontraktues po ashtu ka bërë shkelje të nenit 10 të Ligjit për Prokurimin Publik pasi që nuk ka ofruar qasje në atestet e operatorit të rekomanduar për kontratë në Llot 2, me arsyetimin se është kërkuar sekret afarist. Siç dihet nga praktika e deri tanishme kriteret vlerësuese si përmbajtja e materialit nuk mund të mbrohen si sekrete afariste, pasi që në to nuk ka të dhëna që mund të dëmtojnë konkurrencën e lirë në mes të operatorëve.

**Ekspertja shqyrtuese** sqaron se, lidhur me vlerësimin për pjesën e parë (LOT 1), OE ankues ka paraqitur atestet dhe akreditimin, të cilat konfirmojnë përbërjen e materialit në përqindje. Megjithatë, bazuar në fotot e mostrave të bashkëngjitura nga AK, vërehet se qepja e tiktave është jo profesionale: shihen penjë të dukshme dhe qepje të çrregullta. Për këtë

arsye, komisioni i vlerësimit konteston specifikat teknike, konkretisht kërkesën për qepje profesionale dhe të fortë me penjë profesional. Nga vizualizimi i tiketës rezulton se qepja nuk është e realizuar sipas standardeve të kërkuara.

Duke qenë se mostrat përbëjnë pjesë të testit teknik të domosdoshëm për vlerësimin e tenderit dhe, sipas nenit 37.6 të RrPP-së, modeli i dorëzuar është ai që do të furnizohet AK-së dhe do të ruhet në depot e saj deri në përfundim të kontratës, atëherë kjo mostër konsiderohet jo në përputhje me specifikat teknike sa i përket qepjes profesionale. **Për rrjedhojë, pretendimi i OE ankues nuk vlerësohet si i qëndrueshëm.**

#### **Kërkesë në specifika:**

- **Komplet qepja te jete e forte dhe e sigurt (qepje profesionale dhe penjës profesional)**

Sa i përket logos ose emrit të firmës brenda pizhamave, ekspertja shqyrtuese vlerëson se pretendimi i OE ankues është i qëndrueshëm. Kjo për faktin se prodhuesi është vendor dhe, nëse logoja ose emri i firmës do të ishte i shpalosur, vlerësimi i mostrës do të bëhej subjektiv. Për më tepër, sipas nenit 37.4 të Rregullores për Prokurim Publik, specifikohet qartë se logot në mostra duhet të largohen.

**Sa i përket pjesës II (LOT 2), AK nuk ka ofruar qasje në ofertën e OE të rekomanduar, duke përfshirë edhe mostrat, me arsyetimin se OE ka nënshkruar ankesin për sekrete afariste.** Megjithatë, ekspertja shqyrtuese thekson se në ofertën e OE të rekomanduar gjendet ankesi, në të cilin kërkohet që si informata sekrete afariste të identifikohen dokumentacioni i deklaratave tatimore vjetore, asetet dhe lista e kontratave. Mostrat, sipas ekspertës, nuk mund të konsiderohen si sekrete afariste.

Për këtë arsye, pretendimi i OE ankues vlerësohet i qëndrueshëm **dhe rekomandohet që pjesa II të kthehet në rivlerësim.**

**Si përfundim**, sipas sqarimeve në pretendimet ankimore të OE ankues, rezulton se, ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, **pjesa I** rekomandohet të mbetet në fuqi ndërsa **pjesa e II** të kthehet në rivlerësim.

#### **REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES**

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës për **PJESËN II** dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim, **ndërsa PJESA I të mbetet në fuqi.**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “WOOD CORPORATION L.L.C.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIM ME PIZHAME DIMRI DHE ÇORAPË PËR ZYRTARET POLICORË” me numër të prokurimit: “214/30400-25-9367-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **WOOD CORPORATION L.L.C.**



**Blerina Huruglica**